

VENDIM
Nr. 912, datë 24.12.2019

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOZHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË, TË NJË PJESE TË PRONËS NR.
180, ME EMËRTIMIN “POLICIA USHTARAKE (REPARTI USHTARAK NR.6620)”, ME
VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 404, DATË 4.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË
PËRDORIM TË PËRKOZHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E BRENDSHME, TË NJË PJESE TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 180,
ME EMËRTIMIN “POLICIA USHTARAKE (REPARTI USHTARAK NR. 6620)”, ME
VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5, e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje truall funksional dhe objekti, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) m², nga truall funksional i pronës nr. 180, me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planrilevimit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për realizimin e programeve arsimore, ndërtimin e një shkolle të re publike.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Bashkia Tiranë, të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve, për dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.

4. Në vendimin nr. 404, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, për një periudhë 20-vjeçare, të një sipërfaqeje truall funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 24 141.4 (njëzet e katër mijë e njëqind e dyzet e një pikë katër) m², nga truall funksional i pronës nr.180, me emërtimin “Policia Ushtarake (Reparti Ushtarak nr. 6620)”, me vendndodhje në Sauk, Tiranë, sipas planrilevimit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale.”.

b) Planrilevimi bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me planrilevimin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve, të pasqyrojnë ndryshimin e sipërfaqes së pronës, sipas planrilevimit, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

i pronës nr.180 Policia Ushtarake (Sipërfaqja dhe objektet që jepen në përdorim Bashkisë Tiranë)

MIRATOHET
KOMANDANTI I POLICISE US
Kolonel Altin KURTI

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 1605.3266.

Nr. Pasurise Vol. Fq

Indeksi i Hartes

K-34-100-(27-B), K-34-100-(28-A).

Shkalla 1: 2500

Adresa e pasurise

Abbonari:

Hartoi

Topograf Ramiz Haxhiu

May 2020

DREITORI I GJUN
Art. Enea SINOMERI

Ark. Enea SINOIMERI
K-34-100-(27-B), K-34-100-(28-A).


Shkalla 1:2500

Adresa e pasurise

Pronari:

Topograf Ramiz Haxhiu


May 2020



PLAN RILEVIMI NR.2

i pronës nr.180 Policia Ushtarake (Sipërfaqja dhe objektet që i jepen në përdorim Ministrisë së Brendshme)

MIRATOHET
KOMANDANTI I POLICISË USHTARAKE
Kolonel Altin KUFRI



Hartoi
Topograf Ramiz Haxhiu
Maj 2020

IDENTIFIKIMI I PASURISË
Zona Kadastrale 1605.3266.
Nr.Pasurise _____ Vol. _____ Fq _____
Indeksi i Hartes
K-34-100-(27-B),K-34-100-(28-A).
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurisë Tirane
Q/F Sauk, Tirane.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Policia Ushtarake .

DREJTORI I IGJIT

Ark. ENEA SINOMERI

